



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

BULETIN

3- MUJOR/NR.

TETOR-DHJETOR

2008

BULETIN

tetor – dhjetor 2008

PASQYRA E TITUVJE KRYESORË :

1. Të drejtat dhe liritë e njeriut
10 vjet pas miratimit të Kushtetutës

2. KShH-ja adreson problemet
e zbatimit të standardeve të
të drejtave të njeriut te
institucionet shtetërore

3 Të drejtat e shtetasve dhe
rivendosja e tyre

4 Shëndetësia

5 Veprimtari trajnuese dhe
ndërgjegjësuere për
parandalimin e
diskriminimit

6 Të drejtat e emigrantëve

7 KShH-ja, të drejtat e personave të
dënuar me heqje lirie dhe
administrata e burgjeve

8 Konventa Europiane dhe Gjykata e
Strasburgut nën fokusin e KShH-
së

9 KShH-ja sensibilizon publikun
mes medias së shkruar

10 Tryeza dhe takime

11 Ngritje kapacitetesh të stafit të
KShH-së

KShH-ja bashkorganizon konferencën shkencore me temë “Kushtetuta e Shqipërisë, 1998-2008: 10 vjet më pas”

Me rastin e 10-vjetorit të miratimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, më 27 nëntor 2008, KShH-ja, në bashkëpunim me Universitetin European të Tiranës dhe Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, organizuan konferencën shkencore me temë “Kushtetuta e Shqipërisë, 1998-2008: 10 vjet më pas”.

Vijon në faqen 1

KShH-ja adreson dukurinë e mbipopullimit në institucionet më të larta shtetërore

Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për mbipopullimin në burgjet shqiptare, KShH-ja u adresoi një letër të hapur përfaqësuesve më të lartë shtetit shqiptar dhe institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Vijon në faqen 2

Rritja e kapaciteteve të administratave bashkiake për një respektim më të mirë të të drejtave të minoritetit rom dhe të komunitetit egjiptian

Më 19 shtator, si dhe më 16 dhe 27 tetor 2008, KShH-ja, në bashkëpunim me Qendrën për Studime Ekonomike dhe Sociale, organizoi seminare trajnuese në bashkitë e rretheve Elbasan, Fier dhe Korçë.

Vijon në faqen 4

Për më shumë informacion, mund të na kontaktoni në adresën:

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Rr. “Gjin Bue Shpata”, pall. 5/1,
ap.4, Tiranë, P.O Box nr. 1752
Web-site: www.ahc.org.al

Tel: 04 22 33 671
Cel: 068 20 23 699;
E-mail: office@ahc.org.al

Përgatiti buletin: Erida Skëndaj

Administratore zyre/

Asistente ligjore

Redaktimi letrar: Marie Mato

1 TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT - 10 VJET PAS MIRATIMIT TË KUSHTETUTËS

Me rastin e 10-vjetorit të miratimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, më 27 nëntor 2008, KShH-ja, në bashkëpunim me Universitetin Europian të Tiranës dhe Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, organizuan konferencën shkencore me temë “Kushtetuta e Shqipërisë, 1998-2008: 10 vjet më pas”.

Personalitete të njohura të jetës akademike-juridike dhe hartues të Kushtetutës vunë në pah përpjekjet e bëra për hartimin e Kushtetutës, vështirësitë e hasura; aspekte të parlamentarizimit dhe sistemit gjyqësor në provën e funksionimit të Kushtetutës; qëndrueshmërinë e Kushtetutës në harkun kohor të së shkuarës dhe të së ardhmes; ndryshimet kushtetuese, transparencën e tyre dhe debatet që i kanë shoqëruar.

Gjatë konferencës mori fjalën znj. V.Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, e cila bëri një analizë të respektimit të lirive dhe të të drejtave të njeriut në harkun 10-vjeçar, problemet me të cilat përballen shtetasit në sistemin e drejtësisë, në paraburgim dhe në burgje dhe rolin e institucioneve monitoruese në respektimin e të drejtave të njeriut.

2. KSHH-JA ADRESON PROBLEMET E ZBATIMIT TË STANDARDEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT TEK INSTITUCIONET SHTETËRORE

2.1 Mbipopullimi në burgjet shqiptare - problem që kërkon zgjidhje

Bazuar në të dhënat e monitorimeve dhe gjendjen e mbipopullimit në burgjet shqiptare, KShH-ja, në bashkëpunim me Agjencinë Holandeze të Institucioneve të Korrektimit, u adresoi një letër të hapur përfaqësuesve më të lartë shtetit shqiptar dhe institucioneve shtetërore përgjegjëse: z. Bamir Topi, president i Republikës; znj. Jozefina Topalli, kryetare e Kuvendit; z. Sali Berisha, kryeministër; z. Enkelejd Alibeaj, ministër i Drejtësisë; znj. Ina Rama, Prokurore e Përgjithshme dhe z. Gazmend Dibra, drejtor i përgjithshëm i Burgjeve.

Nëpërmjet kësaj letre KShH-ja rekomandonte hartimin e strategjive gjithëpërfshirëse për zbutjen e mbipopullimit, zbatimin e amnistisë dhe të faljes, zbatimin e dënimeve alternative dhe masave të sigurimit në përputhje me rrezikshmërinë e veprës dhe të personit.

2.2 Reforma zgjedhore - pjesë e diskutimit në seancën dëgjimore të Komisionit Zgjedhor Parlamentar

Më 7 tetor 2008, znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, së bashku me disa përfaqësues të shoqërisë civile morën pjesë në seancën dëgjimore në Komisionin Parlamentar të Reformës Zgjedhore. Znj. Hysi solli në vëmendje të Komisionit disa çështje të rëndësishme, si: dokumentacionin për votim në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, listat zgjedhore dhe procedurat e rishikimit të saj, rishikimin dhe përmirësimin e kreut të referendumeve, të drejtën e emigrantëve të rregullt shqiptarë për të votuar, përfaqësimin më të mirë të grave dhe të minoriteteve, si dhe rregullimin më të mirë të rolit të organizatave vendore në monitorimin e procesit zgjedhor.

Gjithashtu, përfaqësuesja e KShH-së shprehu mendimin se administrata zgjedhore në të gjitha nivelet duhet të jetë teknike, jo politike dhe komisionet zgjedhore duhet të përbëhen nga një numër më i vogël anëtarësh.

3. TË DREJTAT E SHTETASVE DHE RIVENDOSJA E TYRE

3.1 Qytetarët i adresohen KShH-së

Gjatë periudhës tetor – dhjetor 2008 KShH-ja trajtoi 154 ankesa, të ardhura kryesisht nga personat e paraburgosur dhe të dënuar, por edhe shtetas të tjerë. Objekti i ankesave kishte të bënte me shkeljen e të drejtave në burg/paraburgim, pretendime për ushtrim dhune nga personeli i burgut, kërkesa për transferime; me shkelje të së drejtës për të pasur një proces të rregullt ligjor, si dhe pretendime për vendime të padrejta gjyqësore ose pafajësi.

KShH-ja u ka ofruar këshillim ligjor ankuesve dhe, për shkeljet e konstatuara, ka adresuar shqetësimet në organet shtetërore përkatëse.

3.2 Reagime publike për shkelje të të drejtave të shtetasve

Gjatë periudhës tetor – dhjetor 2008, KShH-ja ka reaguar mes deklaratave publike për çështje të tilla, si: dhuna e ushtruar nga oficerët e policisë në komisariatit e Sarandës ndaj dy personave të ndaluar, greva e urisë së disa deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë për reformën zgjedhore; reagimi i drejtorisë së policisë të rrethit të Shkodrës ndaj Avokatit të Popullit si dhe dhuna e ushtruar ndaj gazetarit Luan Kondi. Nëpërmjet deklaratave, KShH-ja ka ritheksuar rëndësinë e të drejtave dhe lirive të tilla, si: e drejta për të mos iu nënshtruar torturës dhe dënimeve çnjerëzore dhe poshtëruese, liria e fjalës etj. duke rekomanduar edhe marrjen e masave përkatëse për ndryshimin e situatës.

4.0 RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PACIENTËVE

4.1 KShH-ja monitoroi kuadrin ligjor në fushën e shërbimit të kujdesit shëndetësor

Në kuadër të nismës për të kontribuar në përmirësimin e të drejtave të njeriut në fushën e shërbimit të kujdesit shëndetësor, KShH-ja kreu një studim të kuadrit ligjor për shërbimin e kujdesit shëndetësor. Studimi paraqet në mënyrë të paanshme dhe objektive legjislacionin shqiptar në fushën e shërbimit të kujdesit shëndetësor, nismat ligjore, institucionale dhe financiare të ndërmarra nga shteti shqiptar, të para nga këndvështrimi i Kartës Sociale Europiane dhe standardet e tjera ndërkombëtare, si dhe ka identifikuar mangësitë dhe problemet që ndikojnë në respektimin e të drejtave të pacientëve.

Gjetjet e studimit dhe rekomandimet përkatëse iu paraqitën institucioneve përgjegjëse shtetërore.

4.2 Takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore shëndetësore

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2008 KShH-ja realizoi disa takime me përfaqësues të institucioneve shëndetësore në nivel qendror e vendor me qëllim vendosjen e kontakteve dhe institucionalizimin e në kuadër të nismës së monitorimit të respektimit të të drejtave

të shtetasve në shërbimin shëndetësor. Në takimin me znj. Anila Godo, ministre e Shëndetësisë, u diskutua për shqetësimet e adresuara KShH-së lidhur me shërbimin e kujdesit shëndetësor, respektimin e të drejtave të njeriut dhe nivelin e zbatimit të legjislacionit në spitale, në institucionet psikiatrike, burgje dhe institucionet e paraburgimit. Gjithashtu, korrespondentët e KShH-së në rrethet Shkodër, Vlorë dhe Elbasan kanë marrë takime me drejtuesit e spitaleve psikiatrike, shtëpitë e fëmijës dhe urdhrat e mjekut.

4.3 Për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut në fushën e kujdesit të shërbimit shëndetësor

Për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut në fushën e kujdesit të shërbimit shëndetësor, më 22 dhjetor 2008, KShH-ja organizoi trajnimin për rritjen e kapaciteteve profesionale të aktivistëve, të stafit dhe të korrespondentëve të tij në fushën e kujdesit të shërbimit shëndetësor. Trajnimi u krye në kuadër të një raundi misionesh monitorimi që KShH-ja do të realizojë në muajt e ardhshëm në disa institucioneve shëndetësore, spitale psikiatrike dhe shtëpi fëmijësh. Qëllimi kryesor i aktivitetit ishte rritja e kapaciteteve profesionale të pjesëmarrësve në këtë fushë dhe ofrimi i informacioneve të vlefshme për metodologjinë e vëzhgimit të KShH-së.

Pjesëmarrësit në trajnim ishin një grup aktivistësh të KShH-së të përbërë nga juristë, mjekë, punonjës socialë si dhe stafi e korrespondentët e KShH-së në rrethe.

Veprimtaritë e mësipërme u mundësuan falë mbështetjes financiare të Departamentit të Shtetit të ShBA-së, Fondi Federal i Ndihmës.

5.1 VEPRIMTARI TRAJNUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE PËR PARANDALIMIN E DISKRIMINIMIT

5.1 Rritja e kapaciteteve të administratave bashkiake për një respektim më të mirë të të drejtave të minoritetit rom dhe të komunitetit egjiptian

Më 19 shtator dhe më 16 dhe 27 tetor 2008, KShH-ja, në bashkëpunim me Qendrën për Studime Ekonomike dhe Sociale, organizoi seminare trajnuese në bashkitë e rretheve Elbasan, Fier dhe Korçë. Qëllimi kryesor i trajnimeve ishte rritja e ndërgjegjësimit dhe E informimit të punonjësve të administratave bashkiake për të drejtat e minoritetit rom dhe të komunitetit egjiptian.

Çështjet kryesore që u trajtuan në trajnim, ishin standardet ndërkombëtare dhe kombëtare për respektimin e të drejtave të personave me përkatësi minoritare/komunitare, detyrimet e institucioneve shtetërore në zbatim të tyre. Dhe rekomandimi nr. 7 e E CRI-t në këtë fushë.

Në këto aktivitete morën pjesë përfaqësues të administratës së bashkive Fier, Roskovec, Elbasan dhe Korçë, si edhe punonjës të komunave që kanë përqendrim të minoritetit rom dhe të komunitetit egjiptian.

Veprimtaritë u realizuan me mbështetjen financiare të Fondacionit të Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, Soros.

5.2 Rritja e kapaciteteve profesionale e minoritetit rom, për një përfaqësim më të mirë pranë institucioneve vendore

Më 13 tetor 2008, KShH-ja, në bashkëpunim me Qendrën për Studime Sociale dhe Ekonomike, trajnuan përfaqësues të minoritetit rom në komunën e Levanit në Fier. Objektivi i trajnimit ishte rritja e kapaciteteve profesionale të përfaqësuesve të minoritetit rom për një përfaqësim më të mirë të të drejtave të tyre ligjore pranë institucioneve vendore nëpërmjet informimit të tyre për detyrat e institucioneve shtetërore vendore përkundrejt qytetarëve. Tema me interes për pjesëmarrësit ishin mënyrat dhe format e komunikimit me organet e qeverisjes vendore për një adresim më të mirë të problemeve dhe shqetësimeve të tyre.

Këto aktivitete u realizuan falë mbështetjes financiare të Fondacionit të Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, Soros.

5.3 Policia shqiptare trajnohet për standardet ndërkombëtare në fushën e mosdiskriminimit

Më qëllim parandalimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në polici, për rritjen e aksesit të minoriteteve në vendimmarrje dhe jetën publike, për të njohur më mirë përmbajtjen e rekomandimeve të Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), KShH-ja, në bashkëpunim me Qendrën për Studime Sociale dhe Ekonomike dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, zhvilluan trajnimet e punonjësve të policisë së qarkut Elbasan dhe Korçë. Këto aktivitete janë realizuar në datat 9 dhe 10 dhjetor 2008.

Pjesëmarrësit u njohën me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të minoritetit rom dhe egjiptian, traditat, kulturën e tyre, gjendjen dhe perspektivën e këtyre komuniteteve si edhe legjislacionin shqiptar për mosdiskriminimin.

Këto aktivitete u realizuan falë mbështetjes financiare të Fondacionit të Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, Soros.

6.0 KSHH-JA DHE TË DREJTAT E EMIGRANTËVE

6.1 KShH-ja vëzhgon respektimin e të drejtave të shtetasve në disa pika të kalimit të kufirit

Gjatë muajit dhjetor 2008 KShH-ja kreu misionet monitorimi në pikat kufitare: Kapshticë, Tushemisht, Goricë, Qafë-Thanë, Kakavijë, porti i Vlorës dhe i Durrësit. Qëllimi i monitorimeve ishte vëzhgimi i respektimit të të drejtave ligjore të emigrantëve shqiptarë dhe personave të kthyer nga marrëveshja "Për ripranimin" me shtetet europiane nga ana e policisë shqiptare dhe asaj të huaj.

Në përfundim të këtyre vëzhgimeve, KShH-ja u dërgoi institucioneve përgjegjëse shtetërore përfundimet dhe disa rekomandime për përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në këto pika kufitare.

Realizimi i këtij aktiviteti u mundësua falë mbështetjes financiare të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

6.2 Konferenca për shtyp "Në mbrojtje të të drejtave të emigrantëve shqiptarë"

Me rastin e 60-vjetorit të nënshkrimit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, më 11 dhjetor 2008, KShH-ja dhe Instituti Kombëtar i Diasporës Shqiptare organizuan një konferencë për shtyp me përfaqësues të medias elektronike dhe të shkruar. Në këtë konferencë u prezantua bashkëpunimi i KShH-së me Institutin Kombëtar të Diasporës në përgatitjen e materiali informues “Në mbrojtje të të drejtave të emigrantëve shqiptarë në Itali dhe në Greqi”. Botimi synon t’u vijë në ndihmë emigrantëve shqiptarë që jetojnë në Itali dhe në Greqi përmes ofrimit të një adresari të disa prej shoqatave shqiptare dhe organizmave ndërkombëtarë kryesorë që punojnë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shtetet fqinje.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore shqiptare dhe aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile, organizatave jofitimprurëse që veprojnë në Shqipëri, Itali dhe Greqi për të garantuar një mbrojtje më të mirë të të drejtave të emigrantëve shqiptarë në këto shtete.

Realizimi i këtij aktiviteti u mundësua falë mbështetjes financiare të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

7.0 KSHH-JA, TË DREJTAT E PERSONAVE TË DËNUAR ME HEQJE LIRIE DHE ADMINISTRATA E BURGJEVE

7.1 Monitorimi i vendeve të paraburgimit

Gjatë periudhës tetor- dhjetor 2008, KShH-ja realizoi vëzhgime në institucionin e paraburgimit në rrugën “Jordan Misja”, në Tiranë; atë në rrugën “Mine Peza”, në Tiranë, në institucionet e paraburgimit në Berat, Durrës, Vlorë, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim: “Shën Koll” Lezhë, Vaqar, Fushë-Krujë, Krujë, në rrugën “Ali Demi” në Tiranë si edhe në spitalin e burgjeve në Tiranë. Qëllimi i monitorimeve ishte vlerësimi i situatës së të drejtave të personave të paraburgosur në përgjithësi, i kushteve fizike të jetesës nëpër institucione, i atmosferës së përgjithshme që mbizotëronte në këto institucione, kujdesi social dhe shëndetësor që ofrohej në këto institucione.

Gjetjet e monitorimeve dhe rekomandimet përkatëse u janë adresuar institucioneve përkatëse.

Misionet e monitorimit u mundësuan falë mbështetjes së Komitetit Suedez të Helsinkit.

7.2 VEPRIMTARI PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TË STAFIT TË BURGJEVE

7.2.1 Drejtuesit e lartë të burgjeve shqiptare vizitojnë institucionet e paraburgimit dhe burgjet holandeze

Në datat 6-9 tetor dhe 1-4 dhjetor 2008, KShH-ja, në bashkëpunim me agjencinë holandeze të institucioneve të korrektimit, organizuan dy vizita studimore të drejtuesve të lartë të burgjeve shqiptare, në institucione të ndryshme paraburgimi dhe burgje në Holandë. Synimi i vizitës ishte përfaqja praktike e modelit shqiptar të sistemit të paraburgimit dhe burgjeve me modelin holandez si dhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira në këtë drejtim.

Në këto vizita u trajtuan gjerësisht: sistemi i menaxhimit të burgjeve, decentralizimi i sistemit; struktura dhe funksionaliteti i ndërtesave; profesionalizmi i burimeve njerëzore; delegimi i përgjegjësisë; sistemi i punës së personave të dënuar, siguria në burg.

Në përfundim të vizitës studimore, pjesëmarrësit u angazhuan të përshtatin dhe të përdorin në sistemin shqiptar të burgjeve njohuritë praktike të fituara gjatë kësaj vizite studimore,

Ky aktivitet u krye në kuadër të programit "Drejtimi human i burgjeve", financuar nga Delegacioni i Komisionit European në Tiranë, programet CARDS, 2004.

7.2.2 KShH-ja zhvillon dy sesione pune për përmirësimin e dosjes psikosociale

Më 23-24 tetor 2008 u zhvillua një sesion pune me të gjithë punonjësit e sektorit të kujdesit social të institucionit të Korçës. Disa nga temat e trajtuara ishin: metodat e drejtimit të një institucioni penitenciar; rregullat në institucion; perceptimi i i.e.v.p. - së nga personat e dënuar me heqje lirie; sfidat dhe pengesat e punonjësve të sektorit të kujdesit social në institucion; modelet e raportimit të sjelljes së personit të dënuar me heqje lirie dhe roli i punonjësit social në këtë drejtim.

Në fund të aktivitetit grupi i punonjësve të kujdesit social, nën orientimin e ekspertit ndërkombëtar, hartoi një model të një programi aktivitetesh 1 - javor në i.e.v.p. - në e Korçës me qëllim për të krijuar një programi realist, duke iu ofruar të burgosurve aktivitetet bazë.

Në datat 17-18 nëntor 2008 u zhvillua një sesion pune me përgjegjësit e sektorit të kujdesit social, trajnerët lokalë të institucioneve të paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe përfaqësues nga sektori i problemeve shoqërore në DPB. Qëllimi i veprimtarisë ishte përmirësimi i përdorimit të dosjes psikosociale nga sektori i kujdesit social nëpërmjet forcimit të kapaciteteve trajnuese të trajnerëve lokalë duke evidentuar mangësitë dhe arritjet e modeleve aktuale, si dhe nëpërmjet njohjes me modelet e përdorura në burgjet holandeze.

Në përfundim, grupet e punës hartuan versionet e para të tri formateve konkrete të punës në i.e.v.p. - të, të cilat plotësojnë dhe përmirësojnë përdorimin e dosjes psikosociale.

Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit 'Drejtimi human i burgjeve', financuar nga Delegacioni i Komisionit European në Tiranë, në kuadër të programeve CARDS, 2004.

7.2.3 Sesion pune për trajtimin e të miturve dhe grave

Më 19 dhjetor 2008, KShH-ja organizoi një sesion pune lidhur me modulet e trajnimit për punonjësit e sapopërzgjedhur në sistemin e burgjeve, lidhur me trajtimin e të miturve dhe grave në këto institucione. Qëllimi i veprimtarisë ishte finalizimi i moduleve për të miturit dhe gratë si edhe vendosja e tyre në programin fillestar të detyrueshëm të trajnimit të punonjësve që do të punojnë në sistemin e burgjeve shqiptare.

Pjesëmarrës në sesionin e punës ishin përfaqësues të sektorit të trajnimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si edhe trajnerë lokalë që janë trajnuar më parë nga KShH-ja për çështjet e të miturve dhe grave në institucionet penitenciare.

Këto veprimtari u realizuan në kuadër të projektit "Për një respektim më të mirë të të drejtave të të miturve dhe grave në institucionet penitenciare", mbështetur nga UNICEF-i, Tiranë, me ndihmën financiare të SIDA-s dhe Komisionit European .

7.2.4 Trajnerët lokalë shqiptarë trajnojnë administratën e burgjeve

Në datat 4-6 nëntor 2008, KShH-ja ndërmori një mision vazhdues për të mbikëqyrur dhe për të vlerësuar tre trajnerë lokalë të burgjeve nga tri institucione lokale penitenciare: Fushë-Krujës, Peqinit dhe Rrogozhinës. Trajnerët u trajnuan për trajtimin e të miturve dhe grave në institucionet penitenciare, bazuar në programin e shkruar të aktivitetit të 'Trajnim trajnerësh', të organizuar nga KShH-ja në qershor të 2007-ës.

Përgjatë tri ditëve të trajnimit, u trajtuan temat, si: menaxhimi i konflikteve në institucione, ulja e agresivitetit të personave të dënuar me heqje lirie dhe roli i punonjësve të burgjeve në këtë drejtim, struktura e komunikimit dhe e bashkëpunimit mes sektorëve në institucion. Të gjitha këto tema u bazuan në modulën e përgatitur për trajnerët lokalë shqiptarë.

Për të mbikëqyrur dhe për të mbështetur këtë mision vazhdues morën pjesë z. Jan van den Brand, ekspert nga Shërbimi Holandez i Burgjeve dhe znj. Edlira Papavangjeli, drejtuese e projektit në KShH.

Këto veprimtari u realizuan në kuadër të projektit "Për një respektim më të mirë të të drejtave të të miturve dhe grave në institucionet penitenciare", mbështetur nga UNICEF-i, Tiranë, me ndihmën financiare të SIDA-s dhe Komisionit Europian.

7.2.5 Trajnohen punonjësit e përzgjedhur rishtas në këtë institucion

Në datat 10-12 dhjetor 2008 KShH-ja organizoi një trajnim të fokusuar te punonjësit me uniformë të përzgjedhur rishtas në institucionin e Fushë-Krujës. Objektivi kryesor i këtyre trajnimeve ishte rritja e aftësive profesionale të personelit me uniformë të institucionit. Temat e trajtura në këto trajnime ishin mbi organizimin dhe funksionimin e një burgu; kujdesi për personelin dhe përzgjedhja e tij; aftësitë profesionale dhe sjellja ndaj të dënuarve; të dënuarit dhe kontaktet me botën jashtë; politikat disiplinore; kërkesë-ankesat; protokollat e ndryshme lidhur me vetëvrasjet; sëmundjet ngjitëse etj. Ekspertët ndërkombëtarë z. Jan van den Brand dhe z. Cees Boeij dhanë kontributin e tyre në këtë trajnim. 30 punonjës me uniformë u trajnuan dhe u pajisën me certifikata për përfundimin me sukses të këtij trajnimi bazë.

Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit "Drejtimi human i burgjeve", financuar nga Delegacioni i Komisionit Europian në Tiranë, në kuadër të programeve CARDS, 2004.

7.2.6 Inaugurohet institucioni i ri penitenciar i Fushë-Krujës

Më 12 dhjetor 2008, u organizua ceremonia e inaugurimit të institucionit të Fushë-Krujës. Të ftuar në këtë ceremoni ishin: z. Enkelejd Alibeaj, ministër i Drejtësisë; z. Helmut Lohan, ambasador i Delegacionit të Komisionit Europian në Tiranë; z. Gazmend Dibra, drejtor i përgjithshëm i Burgjeve; z. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së; z. Jan van den Brand, përfaqësues i Agjencisë Holandeze të Institucioneve të Korrektimit, si edhe përfaqësues të tjerë të institucioneve shtetërore të kësaj fushe.

8.0 KONVENTA EUROPIANE DHE GJYKATA E STRASBURGUT NËN FOKUSIN E VEPRIMTARISË SË KSHH-SË

8.1 Fuqizimi i kapaciteteve të OJF-ve nëpërmjet përdorimit më të mirë të mekanizmave mbrojtës të Këshillit të Europës

Në datat 2-3 tetor 2008, në kuadër të rritjes së kapaciteteve të organizatave që ofrojnë shërbime ligjore, KShH-ja organizoi trajnimin “Këndvështrimi i përgjithshëm i mekanizmave mbrojtës të Këshillit të Europës- Aspekte procedurale dhe teorike për përfaqësimin e rasteve në GJEDNJ-së”. Në trajnim u trajtuan aspekte ligjore dhe praktike të drejtave të sanksionuara në konventë, si: e drejta për të jetuar (neni 2), ndalimi i torturës (neni 3), e drejta për një proces të rregullt ligjor (neni 6), e drejta e privatësisë dhe e familjes (neni 8) dhe e drejta për mosdiskriminim (neni 14); si dhe mekanizmat mbrojtës të Këshillit të Europës.

Z. Sokol Puto, ekspert i pavarur; z. Andi Dobrushki, avokat në Qendrën Europiane për të Drejtat e Romëve; znj. Elira Kokona, eksperte dhe këshilltare ligjore në Këshillin e Europës; znj. Suela Mëneri, përfaqësuese ligjore e shtetit shqiptar dhanë ekspertizën e tyre në këtë trajnim.

Trajnimi u mundësua falë mbështetjes së Komitetit Suedez të Helsinkit.

8.2 KShH-ja merr pjesë në takimin e grupit të punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme

KShH-ja mori pjesë në takimin e grupit të punës organizuar nga Zyra e Përfaqësuesit Ligjor në MPJ lidhur me ecurinë e zbatimit të 5 rekomandimeve të **Këshillit** të Ministrave, drejtuar shtetit shqiptar. Në këtë tryezë u diskutuan aspekte ligjore dhe praktike të këtij procesi. Përfaqësuesja ligjore, znj. Mëneri, ftoi të gjithë pjesëmarrësit të ishin pjesë e grupit të punës që do të ngrihej për përzgjedhjen e 10 vendimeve më të mira që do të publikoheshin në QPZ si dhe kërkoi mendime dhe rekomandime lidhur me procesin e bazueshmërisë dhe të përafrimit të legjislacionit shqiptar me KEDNJ-në dhe aktet e tjera ndërkombëtare.

Znj. Etilda Saliu, që përfaqësoi KShH-në në këtë takim, vlerësoi propozimin e bërë dhe nënvizoi domosdoshmërinë e ngritjes së një mekanizmi zbatues të vendimeve të dhëna nga Gjykata Kushtetuese.

8.3 KShH-ja jep ekspertizën e tij në seminarin lidhur me rolin e agjentit qeveritar para GJEDNJ-së

Më 11-12 nëntor 2008, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dha ekspertizën e tij në seminarin dyditor të organizuar për rolin e agjentit qeveritar para Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në seminar u trajtuan disa aspekte ligjore dhe praktike, të disa prej neneve të KEDNJ-së, si: neni 1, protokollin nr.1 (e drejta e pronësisë), neni 3 (ndalimi i torturës) dhe neni 5 (e drejta për siguri dhe liri). Këto të drejta u trajtuan nën dritën e vendimeve të dhëna nga GJEDNJ-ja ndaj vendit tonë.

Znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, trajtoi në këtë seminar të drejtat e personave të paraburgosur dhe të dënuar sipas legjislacionit shqiptar dhe problemet e zbatimit të ligjit në praktikë.

Seminari u organizua nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Europës.

8.4 KShH-ja trajnon përfaqësues të OJF-ve lokale, juristë dhe pedagogë në disa rrethe të Shqipërisë

Me qëllim ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të organizatave lokale, juristëve dhe pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë, për aspekte ligjore dhe praktike të disa prej neneve të konventës europiane dhe veprimtarinë e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në datat **17, 18 dhe 21 nëntor 2008**, KShH-ja, në bashkëpunim me Këshillin e Europës, organizoi disa trajnime në rrethet Elbasan, Shkodër dhe Vlorë.

Në këto trajnime dhanë ekspertizën e tyre ekspertë të njohur të fushës, si: z. Sokol Puto, ekspert i pavarur; znj. Suela Mëneri, përfaqësuese ligjore e shtetit shqiptar dhe znj. Etilda Saliu.

Trajnimet u mundësuan financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit në bashkëpunim me Këshillin e Europës.

9 KSHH-JA SENSIBILIZON PUBLIKUN MES MEDIAS SË SHKRUAR

Të drejtat e njeriut, reforma në drejtësi dhe reforma zgjedhore- në një debat televiziv në Ora News

Më 16 tetor 2008, znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, ishte e ftuara e TV Ora News për të diskutuar rreth gjendjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe reformat ligjore. Në program, ajo ritheksoi nevojën e vëzhgimit të respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, zhvillimin e reformës në drejtësi dhe asaj zgjedhore me pjesëmarrje të gjerë të grupeve të interesuara, përsheptimin e ritmeve të miratimit të Kodit zgjedhor dhe përgatitjes së infrastrukturës zgjedhore, sidomos listave dhe kartave të identitetit të shtetasve.

Gjithashtu, znj. Hysi nënvizoi nevojën e zhvillimit të reformës në drejtësi me diskutim të gjerë, duke synuar rritur e profesionalizmit, efektivitetit, efikasitetit dhe pavarësisë së sistemit gjyqësor.

Kushtet e dhomave të shoqërimit dhe të ndalimit nën vëmendjen e TV Shijak

Më 30 tetor 2008, znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, dha një intervistë në TV Shijak lidhur me përfundimet e monitorimit të dhomave të shoqërimit dhe të ndalimit në disa komisariate të vendit. KShH-ja ka shprehur shqetësimin për kushtet higjieno-sanitare në këto mjedise, për mungesën e mjediseve të veçanta për të miturit dhe gratë dhe infrastrukturën tejet të amortizuar të një pjese të mjediseve. Sipas KShH-së, infrastruktura dhe kushtet higjieno-sanitare ndikojnë në mosrespektimin e të drejtave të personave që shoqërohen ose ndalohen.

Respektimi i të drejtave të personave të ndaluar dhe të arrestuar

Rasti i keqtrajtimit të një të riu nga policia e Sarandës u bë pjesë e një debati televiziv në televizionin NEWS 24, të datës 13 nëntor 2008 ku ishin të ftuar përfaqësues të Avokatit të Popullit, ish-punonjës policie, gazetarë dhe znj. Vasilika Hysi, drejtore

ekzekutive e KShH-së. Duke marrë shkas nga ngjarja, znj. Hysi ritheksoi nevojën e rritjes së profesionalizimit të punonjësve të policisë, të njohjes dhe të zbatimit të të drejtave të personave të arrestuar, rolin e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm monitorues të komisariateve të policisë, vendeve të paraburgimit dhe burgjeve dhe nevojën e ndëshkimit të ashpër të rasteve të keqtrajtimeve nga ana e punonjësve që ushtrojnë pushtet.

Të drejtat dhe liritë e njeriut, 10 vjet pas miratimit të Kushtetutës

Në datat 2- 3 nëntor 2008, me rastin e 10-vjetorit të miratimit të Kushtetutës, znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, ishte e ftuar në një emision në TV A 1. Çështjet e diskutuara ishin: të drejtat dhe liritë e shtetasve pas miratimit të Kushtetutës, progresi i bërë dhe problemet që ekzistojnë, të drejtat më të cenuara në këta 10 vjet, reforma në drejtësi, ndryshimet e Kushtetutës dhe trajtimi i personave të dënuar me heqje lirie. Njohja dhe zbatimi i Kushtetutës, si dhe nevoja e informimit të publikut ishin, gjithashtu, objekt i diskutimit.

10. TRYEZA DHE TAKIME ME PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE, TË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE TË ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE

10.1 KShH-ja merr pjesë në takimin e organizuar lidhur me fushatën zgjedhore në SHBA

KSHH-ja mori pjesë në takimin e organizuar lidhur me disa aspekte të fushatës zgjedhore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë takim, përfaqësues të ambasadës amerikane prezantuan fushatën zgjedhore në Amerikë duke paraqitur, gjithashtu, dhe problematikën e parë nga fushata e secilit kandidat për zgjedhjet në Amerikë. Pjesëmarrësit, përfaqësues të shoqërisë civile, nëpërmjet pyetjeve drejtuar të ftuarve, shfaqën interes të veçantë lidhur me transparencën e fondeve të fushatës, si dhe për procedurat dhe kriteret e financimit.

Veprimtaria u zhvillua më 13 tetor 2008 nga ambasada amerikane. Përfaqësuese e KShH-së në këtë takim ishte znj. Etilda Saliu, koordinatore e klinikës ligjore në KShH.

10.2 KShH-ja merr pjesë në takimin e organizuar për fëmijët jetimë

Më 14 tetor 2008 KShH-ja mori pjesë në takimin e organizuar për problematikën që hasin në Shqipëri fëmijët jetimë nga 0 deri në 18 vjeç, si: indiferenca e institucioneve shtetërore dhe e shoqërisë civile ndaj tyre; problemet e arsimit dhe të strehimit; mangësitë në legjislacion, si dhe ndryshimi i herëpashershëm i personelit të shtëpive të fëmijës. Në këtë takim pjesëmarrësit dhanë rekomandimet përkatëse për ndryshimin e situatës, si: domosdoshmëria e unifikimit të zbatimit të ligjit për ndihmën sociale; përmirësimi i politikave favorizuese të strehimit për këta fëmijë; afërsia dhe ndërhyrja më e madhe e pushtetit vendor ndaj këtyre fëmijëve etj.

Tryeza u organizua nga Amnesty International. Përfaqësuese e KShH-së në këtë takim ishte znj. Etilda Saliu, koordinatore e klinikës ligjore në KShH.

10.3 KShH-ja merr pjesë në tryezën për “16 ditët e aktivizimit kundër dhunës në familje”

Më 31 tetor 2008 KShH-ja mori pjesë në tryezën e organizuar nga CRCA-ja për t'u paraprirë aktiviteteve të ndryshme që do të zhvilloheshin me rastin e “16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje”. Qëllimi kryesor i kësaj tryeze ishte prezantimi i veprimtarisë së parashikuar nga të gjithë pjesëmarrësit me rastin e këtyre ditëve si dhe bashkërendimi i datave të aktiviteteve të rëndësishme, për të mundësuar pjesëmarrjen e përfaqësuesve përkatës të institucioneve shtetërore dhe të shoqërisë civile.

Përfaqësuese e KShH-së në këtë tryeze ishte znj. Erida Skëndaj, asistente ligjore dhe administratore zyre.

10.4 KShH-ja merr pjesë në mbledhjen e punës “Migracioni shqiptar: Dinamikat, ndikimi dhe mundësitë”

Më 3 nëntor 2008 KShH-ja mori pjesë në mbledhjen e punës “Migracioni shqiptar: Dinamikat, ndikimi dhe mundësitë”. Qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte bashkërendimi sa më i mirë i veprimtarisë së të gjithë aktorëve përgjegjës shtetërorë dhe shoqërisë civile në fushën e emigracionit dhe migrimit. Në këtë kuadër u prezantua një studim për zonat më të prekura nga kjo dukuri, tiparet dhe profilizimi i emigrantëve të kthyer si dhe identifikimi i mundësive ekzistuese për formim profesional të tyre.

Ky aktivitet u organizua nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Përfaqësuese e KShH-së në këtë aktivitet ishte znj. Erida Skëndaj, asistente ligjore dhe administratore zyre.

10.5 KShH-ja merr pjesë në dialogun rajonal për zhvillimin institucional dhe integrimin në BE

Më 13 nëntor 2008 znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, mori pjesë në dialogun rajonal me temë “Zhvillimi institucional dhe integrimi në BE”. Znj. Hysi prezantoi disa nga aspektet teorike dhe praktike të të drejtave të njeriut në Shqipëri si dhe ratifikimin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut nga shteti shqiptar, risitë që solli ajo duke u bërë pjesë e brendshme e legjislacionit shqiptar.

Ky aktivitet u organizua dhe u fiancua nga USAID-i (Hope Fellowships Programme).

10.6 KShH-ja merr pjesë në tryezën e punës për përfshirjen sociale në Shqipëri

Më 10 dhjetor 2008 KShH-ja mori pjesë në tryezën e punës për diskutimin e disa çështjeve dhe problematikave që shoqërojnë përfshirjen sociale të grupeve në nevojë në Shqipëri. Në këtë tryezë ekspertë të njohur të fushës prezantuan “Planin e veprimit për strategjinë e përfshirjes sociale”. Plani përcaktonte fushat parësore ku duhej ndërhyrë dhe aktorët që do të jepnin ndihmesën e tyre në këtë proces. KShH-ja e vlerësoi këtë tryezë si shumë të rëndësishme në përcaktimin e nevojave ku do të ndërhyhet në periudhën në vazhdim, në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj.

Kjo tryezë u organizua nga SOROS-i. Përfaqësuese e KShH-së në këtë tryezë ishte znj. E. Skëndaj, asistente ligjore dhe administratore zyre.

10.7 KShH-ja merr pjesë në mbledhjen e bordit të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Drejtave të Njeriut në Shqipëri

Më 18 dhjetor 2008 KShH mori pjesë në mbledhjen e bordit të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Drejtave të Njeriut në Shqipëri. Në këtë mbledhje u diskutuan filmat e shfaqur në kuadër të këtij Festivali, arritjet e secilit partner në fushën e drejtave të njeriut, si dhe u rinovua bordi drejtues. Edicioni i katërt i filmit u vendos të zhvillohej më 21-24 prill 2009. KShH-ja është një ndër partnerët e festivalit.

Në këtë takim KShH-ja u përfaqësua nga znj. Klejda Ngjela, asistente programi në KShH.

10.8 Pjesëmarrje në mbledhjen e Konsorciumit Ndërkombëtar

Më 12 dhjetor 2008 KShH-ja mori pjesë në mbledhjen e Konsorciumit Ndërkombëtar për Menaxhimin e Integruar të Kufijve. Në takim u prezantua progresi dhe problemet në fushë. KShH-ja prezantoi nismat e realizuara dhe ato të planifikuara për vitin 2009 në zbatim të misionit të tij për kontribuimin në respektimin më të mirë të drejtave të njeriut në pikat kufitare shqiptare.

Në takim morën pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore, aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, organizata jofitimprurëse që punojnë në fushë, donatorë dhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtarë.

KShH-ja u përfaqësua nga znj. Ersida Sefa, koordinatore projekti.

Më 18 dhjetor 2008 KShH-ja mori pjesë në mbledhjen e Konsorciumit Ndërkombëtar lidhur me zhvillimet e fundit të reformës ligjore në fushën e drejtësisë, të burgjeve, drejtësia e sistemit të të miturve etj. Pikë e rëndësishme e takimit ishte edhe përditësimi i anëtarëve të konsorciumit lidhur me veprimtarinë e secilit pjesëmarrës në këtë fushë. Në këtë kuadër, znj. Erida Skëndaj, përfaqësuese e KShH-së, prezantoi nismën e KShH-së për monitorimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit në disa rrethe të Shqipërisë, lidhur me zbatimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjetjet e këtyre monitorimeve do t'u vihen në dispozicion institucioneve përkatëse si dhe do t'u raportohen edhe anëtarëve të konsorciumit.

11. NGRITJE KAPACITETESH TË STAFIT TË KSHH-SË

11.1 KShH-ja merr pjesë në trajnimin “Barazia gjinore dhe integrimi evropian”

Në datat 13 - 14 tetor 2008, znj. Erida Skëndaj, asistente ligjore dhe administratore zyre në KShH, mori pjesë në trajnimin “Barazia gjinore dhe integrimi evropian”. Trajnimi pajisi pjesëmarrësit me njohuri të përgjithshme lidhur me kuadrin ligjor evropian dhe dokumentet ndërkombëtare për barazinë gjinore si dhe trajtoi progresin e vendit tonë në procesin e integritit evropian duke u referuar në përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në kuadër të MSA-së ku përfshihen çështje të barazisë gjinore.

Trajnimi u organizua nga Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim.

11.2 KShH-ja merr pjesë në trajnimin intensiv “Drejtorët e OJF-ve, udhëzim për financat”

Në datat 15-16 dhjetor 2008 KShH-ja mori pjesë në trajnimin intensiv **“Drejtorët e OJF-ve, udhëzim për financat”**. Trajnimi kishte nën fokusin e tij drejtorët dhe stafin menaxhues të OJF-ve dhe pajisi pjesëmarrësit me njohuri lidhur me aspektet financiare të OJF-ve; karakteristikat e parimeve të përgjithshme të kontabilitetit; hapat për përmirësimin dhe hartimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; organizimin e dokumentacionit financiar - strukturën e bilancit, raportit financiar dhe arkës.

Në këtë trajnim morën pjesë përfaqësues të disa OJF-ve kombëtare dhe ndërkombëtare. KShH-ja u përfaqësua nga znj. Katerina Sherko, menaxhere financash dhe znj. Erida Skëndaj, administratore zyre dhe asistente ligjore.

Trajnimi u organizua nga audituesi i KShH-së, Fabel, Werner & Scjnitke Ltd.